



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

**RREGULLORE**

**PËR**

**MËNYRËN DHE AFATIN E PËRLLOGARITJES SË VLERËS NETO TË  
AKTIVEVE TË FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT, ÇMIMIT TË KUOTËS,  
SHNDËRRIMIN E KONTRIBUTEVE NË KUOTA SI DHE MËNYRËN E  
RAPORTIMIT TË INFORMACIONIT**

*Miratuar me Vendim Bordi nr. 104, datë 28.06.2024*

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë:

1. Mënyrën e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit privat;
2. Kërkesat për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit privat, çmimit të kuotës si dhe shndërrimin e kontributeve në kuota;
3. Shpeshtësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit, çmimit të kuotës si dhe mënyrën, kohën e publikimit dhe raportimit të informacionit lidhur me këta tregues.

**Neni 2**  
**Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore përcakton kërkesat që zbatohen nga shoqëritë administruese dhe depozitarët e fondeve të pensionit privat, lidhur me qëllimin e kësaj rregulloreje.

### **Neni 3**

#### **Baza ligjore**

Kjo rregullore hartohet në zbatim të pikës 2, të nenit 14, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar si dhe të pikës 9, të nenit 60, të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”.

### **Neni 4**

#### **Përkufizimet**

Të gjitha përkufizimet e kësaj rregulloreje janë të njëjta me ato të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat” të referuar në këtë rregullore si "Ligj", si edhe të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”. Për qëllime të kësaj rregulloreje me termat e mëposhtëm kuptojmë:

1. **“Dita t”**, është dita në të cilën kryhet përlllogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës mbështetur në të dhënat e mbylljes së një ditë më parë “t-1”.
2. **Dita t-1**, është dita e vlerësimit për të cilën kryhet përlllogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës.
3. **“Ditë e shlyerjes së transaksionit”**, është dita në të cilën kryhet pagesa dhe/ose arkëtimi i shumës përkatëse të transaksionit, në rastin e blerjes apo shitjes së aktivit financiar.
4. **“SNRF”** janë Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
5. **“Treg aktiv”** është tregu në të cilin transaksionet për aktivin ose detyrimin kryhen me frekuencë të mjaftueshme dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme, i cili plotëson kriteret e nenit 7 si dhe shtojcës 2 të kësaj rregullore.
6. **“Ex-divident”** është një veprim korporativ si dividendi, i cili ka një datë të caktuar (ex) dhe mbajtësit e aksioneve të blera para kësaj date kanë të drejtën të marrin dividendin e ardhshëm, ndërsa mbajtësit e aksioneve të blera në atë datë ose pas saj nuk e kanë këtë të drejtë.

**KREU II**  
**PROCEDURA PËR VLERËSIMIN E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE TË FONDIT**  
**TË PENSIONIT PRIVAT**

**SEKSIONI 1**  
**METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE STATUSI I TREGUT**

**Neni 5**  
**Metodologjia e vlerësimit**

1. Rregullat e hollësishme për mënyrën e vlerësimit të të gjitha llojeve të aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit privat, zbatohen nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat për vlerësimin e fondeve që ajo administron dhe nga depozitari në kontrollin e këtij vlerësimi.
2. Metodologjia e vlerësimit duhet të përshkruajë në mënyrë të detajuar metodat dhe teknikat e përdorura për vlerësimin e secilit aktiv në të cilin janë investuar aktivet e fondit si dhe të detyrimeve të fondit të pensionit.
3. Metodologjia e vlerësimit të aktiveve për secilin fond pension duhet të përgatitet nga shoqëria administruese e fondeve dhe të konsultohet me depozitarin.
4. Metodologjia e vlerësimit të aktiveve të fondit të pensionit miratohet nga shoqëria administruese e fondeve dhe nga depozitari dhe depozitohet në Autoritet.
5. Metodologjia e vlerësimit të aktiveve të fondit të pensionit duhet:
  - a. të sigurojë një proces vlerësimi të besueshëm, transparent, gjithëpërfshirës dhe të dokumentuar në mënyrë të përshtatshme;
  - b. të mbulojë aspekte të rëndësishme të procesit të vlerësimit dhe procedurave dhe kontrolleve të vlerësimit;
  - c. të përshkruajë masat mbrojtëse për kryerjen e vlerësimeve funksionale të pavarura, të cilat përfshijnë masat për të parandaluar ose kufizuar çdo person nga ushtrimi i një ndikimi të pajustificueshëm në procesin e vlerësimit.
6. Shoqëria administruese e fondeve është përgjegjëse për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit për çdo anëtar në përputhje me dispozitat e Ligjit.
7. Depozitari, kontrollon dhe verifikon llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimin e kuotës në përputhje me politikat e kontabilitetit dhe metodologjinë e vlerësimit si dhe është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes së këtyre treguesve.

## **Neni 6**

### **Vlerësimi i instrumentave financiare**

1. Instrumentet financiare të listuara dhe të tregtuara në një treg aktiv, përfshirë aksionet ose kuotat e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të regjistruara dhe të tregtuara në këto tregje, vlerësohen në bazë të çmimit më të fundit të tregut në momentin e vlerësimit.
2. Instrumentet financiare, tregtimi i të cilave është joaktiv vlerësohen sipas metodologjisë së parashtruar në nenin 5 të kësaj rregulloreje pas dakordësimit me depozitarin.

## **Neni 7**

### **Tregjet aktive**

1. Çmimi i tregut në një treg aktiv garanton dëshminë më të besueshme të vlerës së drejtë dhe përdoret pa përshtatje për të matur vlerën e drejtë sa herë që është e mundur, me përjashtime të kufizuara.
2. Do të konsiderohen tregje aktive nëse:
  - a. Instrumenti tregtohet në një nga tregjet e listuara në shtojcën 2 të kësaj rregulloreje;
  - b. Në lidhje me instrumentet e borxhit është vlerësuar nga një prej agjencive të vlerësimit të kreditit S&P, Moody's ose Fitch në shkallën "gradë investimi" (*investment grade*);
3. Në lidhje me titujt e tjerë të cilat nuk përmbushin kërkesat e pikës 2 të këtij neni, frekuenca e mjaftueshme e tregtimit është:
  - a. Ku ka kuotime të ekzekutueshme në baza ditore;
  - b. Në rastin e titujve të kapitalit kur ka tregtim të titullit në fjalë për të paktën 20 ditë tregtimi në një periudhë prej nëntëdhjetë ditëve tregtimi;
  - c. Në rastin e titujve të borxhit kur ka tregtim të titullit në fjalë për të paktën 15 ditë tregtimi në një periudhë prej nëntëdhjetë ditëve tregtimi.
4. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, tregu kryesor është tregu i cili zakonisht ka volumin dhe nivelin më të madh të aktivitetit për aktivin ose detyrimin, ose një treg tjetër, i ndryshëm nga tregu kryesor, që në kohën e vlerësimit, gjykohet të jetë tregu më i favorshëm, d.m.th. tregu që maksimizon shumën që do të merrej për të shitur aktivin ose detyrimin në atë kohë.
5. Vetëm për qëllime të vlerësimit, duhet të përdoren çmimet e kuotuar në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike që shoqëria administruese dhe depozitari mund të ketë akses në datën e vlerësimit.
6. Çmimet e përdorura për vlerësim duhet të jenë çmimet më të fundit në dispozicion

menjëherë para pikës së vlerësimit.

7. Nëse nuk përmbushet ndonjë nga kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, titulli trajtohet sikur nuk është tregtuar në treg aktiv dhe vlerësohet në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë rregullore për vlerësimin e titujve në tregjet joaktive.
8. Vlerësimi i tregut duhet të bëhet me frekuencë 3 mujore.

### **Neni 8**

#### **Kritere të tjera në lidhje me përcaktimin e statusit të tregut**

Përveç përcaktimeve në nenin 7 të kësaj rregulloreje, shoqëria administruese për titujt e pjesëmarrjes në kapital (*equities*) do të përcaktojë nëse vepron në treg aktiv apo jo aktiv duke marrë parasysh edhe:

- a. Vëllimin e tregtimit të krahasuar me vëllimin mesatar të tregtimit për periudhën tremujore;
- b. Diferencën ndërmjet çmimit më të fundit të ofruar për blerje dhe çmimit më të fundit të ofruar për shitje;
- c. Vëllimin e tregtimit në raport me kapitalizimin e tregut në periudhë tremujore.

### **Neni 9**

#### **Përgjegjësia për të përcaktuar statusin e tregut**

1. Shoqëria administruese duhet të krijojë një procedurë për kryerjen e rregullt të kontrolleve të përshtatshme të përcaktuar nëse një treg është:
  - a. Treg aktiv;
  - b. Treg jo aktiv por që ekzistojnë çmime për instrumentet financiare të zotëruara nga fondi i pensionit;
  - c. Treg jo aktiv në të cilin nuk ka çmime për instrumentet financiare të zotëruara nga fondi i pensionit.
2. Shoqëria administruese dhe depozitari krijojnë dhe dokumentojnë procedurën për vërtetimin e gjykimit të tyre për klasifikimin e secilës kategori të tregut dhe çdo lloj instrumenti financiar në të.

**SEKSIONI 2**  
**KONTABILITETI DHE PARIMET E VLERËSIMIT**

**Neni 10**

**Vlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit**

1. Politikat kontabël të fondit dhe metoda e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve financiare të fondit të pensionit të cilat përcaktohen nga shoqëria administruese, do bazohen dhe duhet të jenë në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).
2. Njohja e aktiveve dhe detyrimeve të fondit kryhet në varësi të llojit të aktiveve dhe detyrimeve duke aplikuar klasifikimin në përputhje me politikat kontabël të Fondit.

**Neni 11**

**Vlerësimi i aktiveve në monedhë të huaj**

1. Fondet e pensionit privat, çmimi dhe vlera neto e aktiveve të të cilëve është shprehur në lekë dhe që zotërojnë aktive, çmimet e të cilave shprehen në monedhë të huaj, duhet të llogarisin vlerën e aktiveve të fondit, duke zbatuar kursin e këmbimit të publikuar nga Banka e Shqipërisë, për ditën e vlerësimit. Në rastin kur monedha në të cilën janë blerë aktivet nuk është përfshirë në listën e normave të kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, do të përdoren normat mesatare të kursit të këmbimit të kësaj monedhe me euron, marrë nga bankat qendrore përkatëse dhe vlerat e paraqitura në euro, duhet të kthehen në ekuivalentin e tyre në lekë duke zbatuar kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi në ditën përkatëse.
2. Fondet e pensionit privat, vlera neto e aktiveve e të cilave shprehet në monedha të ndryshme nga leku shqiptar duhet të konvertojnë vlerën e aktiveve të tyre, çmimet e të cilave janë shprehur në monedha të ndryshme nga monedha bazë e fondit të pensionit privat, në monedhën bazë në të cilën shprehen instrumentet me kursin e këmbimit në fuqi për ditën e vlerësimit.

**Neni 12**

**Llogaritjet në vijim të vlerës së aktiveve dhe detyrimeve**

1. Llogaritjet në vijim të vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit do të kryhen në varësi të llojit dhe klasifikimit të aktivitetit sipas SNRF.

2. Llogaritjet në vijim të vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit shprehur në një monedhë të huaj, do të kryhen duke zbatuar kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në fuqi për ditën e vlerësimit.

### **Neni 13**

#### **Kontabilizimi për transaksionet e portofolit**

1. Blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare të fondit të pensionit privat, do të përfshihen në vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit në ditën kur transaksioni është përfunduar, në bazë të vlerës së drejtë në ditën e tregtimit. Dita kur transaksioni është përfunduar do të quhet dita kur është mbyllur marrëveshja e tregtimit (*trade date*) nëpërmjet shoqërisë administruese dhe shoqërisë komisionere/bankës që ofron shërbime investimesh me të cilën është kryer transaksioni.
2. Në rastin e blerjes së një aktivi financiar, transaksioni i përfunduar do të njihet si aktiv i fondit të pensionit duke krijuar në të njëjtën kohë detyrimin për shlyerje.
3. Në rastin e shitjes së një aktivi financiar në ditën e përfundimit të transaksionit, aktivi nuk do të bëjë më pjesë në aktivet e fondit të pensionit dhe do të njihet e drejta e transaksionit të përfunduar.
4. Të drejtat apo detyrimet që burojnë nga dividendët, interesat, humbjet ose fitimet nga diferenca e çmimit të aktivit financiar do të përfshihen në shumën totale të aktiveve apo detyrimeve të fondit të pensionit pasi të jetë marrë vendimi i organit kompetent dhe të jetë përcaktuar e drejta për arkëtim apo pagesa për detyrim.
5. Transaksionet e kryera dhe detyrimet e fondit duhet të regjistrohen në librat kontabël, në bazë të dokumenteve kontabël të besueshme dhe të vërteta, sipas vlerës së transaksioneve.

### **Neni 14**

#### **Kontabilizimi për blerjet në emetimin e parë**

Blerja e aktiveve të emetimeve primare do të njihet në aktivet e fondit të pensionit privat në datën e tregtimit. Në rastet e blerjes së aktiveve të emetimeve primare nëpërmjet një ankandi, këto aktive do të njihen në aktivet e fondit të pensionit në datën e konfirmimit dhe shpalljes fitues të ankandit.

**SEKSIONI 3**  
**VLERËSIMI I KATEGORIVE DHE LLOJEVE TË NDRYSHME TË AKTIVEVE TË**  
**FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT**

**Neni 15**

**Vlerësimi i instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv**

1. Për instrumentet financiare të tregtuara në një treg aktiv, vlera e instrumentit financiar llogaritet duke shumëzuar çmimin e tregut më të fundit të disponueshëm me numrin e instrumenteve financiare të zotëruara nga fondi i pensionit.
2. Çmimi i tregut i fundit është çmimi më i fundit i disponueshëm në treg i çmimit në blerje “*bid*” të instrumentit përkatës financiar menjëherë para kohës në të cilën bëhet vlerësimi.
3. “Më i fundit i disponueshëm” nënkupton një çmim jo më të vjetër se çmimi i fundit i paraqitur në ditën më të fundit të punës; ose
  - a. Çmimi me të cilin transaksioni më i fundit në instrumentin përkatës financiar është raportuar në një treg të rregulluar ose në tregjet mbi banak; ose
  - b. Çmimi me të cilin një krijues tregu (*market maker*) ose “internalizues sistematik” kuoton për të blerë instrumentin përkatës financiar në një treg në të cilin ka krijues tregu ose internalizues sistematikë. Në rastet kur ka disa krijues tregu ose internalizues sistematikë përdoret mesatarja e ponderuar e çmimit me vëllimet e kuotuar.

**Neni 16**

**Përjashtimet nga vlerësimi i instrumenteve financiare të tregtuara në një treg aktiv**

1. Çmimet e aktiveve të tregtuara në mënyrë aktive nuk janë të besueshme nëse:
  - a. Tregu ose mekanizmi tjetër i tregtimit ku tregtohet aktivi është subjekt i mbylljes së përkohshme;
  - b. Instrumenti financiar në fjalë ka pasur kuotimin e tij të pezulluar përkohësisht nga tregu ose mekanizmi tjetër i tregtimit për çfarëdo lloj arsye;
  - c. Ka ndodhur një ngjarje e rëndësishme që nga mbyllja më e fundit e tregut kur është marrë çmimi i instrumentit financiar.
2. Çmimet e aktiveve të tregtuara në treg aktiv mund të mos përdoren kur:
  - a. Nuk ka besueshmëri në çmimin që rrjedh nga tregu aktiv, ose
  - b. Ka baza të arsyeshme për të besuar se nuk ekziston ndonjë çmim i besueshëm për një instrument financiar në një pikë vlerësimi, ose
  - c. Nëse çmimi më i fundit i disponueshëm nuk pasqyron vlerësimin më të mirë të shoqërisë administruese për vlerën e një aktivi në pikën e vlerësimit.

## Neni 17

### Vlerësimi për titujt e tregtuar për të cilët ekziston një treg jo aktiv

1. Vlera e drejtë e titujve të transferueshëm, instrumenteve të tregut të parasë dhe instrumenteve të tjera financiare të tregtuara në një treg joaktiv, vlerësohen nga teknikat e vlerësimit, të cilat synojnë të përcaktojnë çmimin me të cilin do të shitej aktivi ose do të shlyhej detyrimi në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut për ditën e vlerësimit.
2. Kur transaksionet për aktivin ose detyrimin në një treg të rregulluar ose platformë tjetër tregtimi nuk zhvillohen me frekuencë të mjaftueshme dhe volume të mjaftueshme për të siguruar informacionin e çmimeve në mënyrë të vazhdueshme siç kërkohet sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, tregu i këtyre aktiveve duhet të konsiderohet si joaktiv.
3. Në rastin e instrumenteve financiare të tregtuara në një treg të rregulluar jo aktiv, mund të jetë e mundur të sintetizohet një çmim tregu nëpërmjet:
  - a. Marrjes së ofertave nga shoqëritë komisionere/bankat që ofrojnë shërbime investimesh ose krijuesit e tregut të cilët duhet të jenë:
    - i. Mesatarja e çmimeve në blerje “*bid*” nga të paktën tre brokera ose krijues tregu;
    - ii. Të ekzekutueshëm idealisht edhe në sasi të vogla.
  - b. Përdorimit të çmimeve të nxjerra nga *yield-et* mesatare të ponderuara të ankandeve të fundit të titujve të borxhit sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje.
  - c. Përdorimit të teknikës së skontimit të flukseve të parasë (*Discounted Cash Flow (DCF)*) për të përlllogaritur vlerën aktuale të flukseve të ardhshme parasë duke përdorur një normat e interesit që dalin nga kurba e *yield-it*.
4. Nëse nuk janë kryer transaksione gjatë 30 ditëve të fundit të tregtimit, çmimi i vlerës së drejtë llogaritet sipas nenit 19 të kësaj rregulloreje.

## Neni 18

### Dispozita të veçanta për vlerësimin e obligacioneve për të cilat nuk ka treg aktiv

1. Për çmimin e titujve të borxhit për të cilat nuk ka treg aktiv mund të përdoret një nga metodat e mëposhtme:
  - a. Përdorimi i kurbës së *yield-it* deri në maturim (*yield to maturity*) nënkupton që një titull borxhi çmohet në bazë të një kurbe *yield-i*, e cila do të bazohet në kurbën e *yield-it* deri në maturim (*yield to maturity*) për obligacionet qeveritare. Nëse nuk ka çmim të tregut aktiv për titujt e borxhit qeveritarë, kurba e *yield-it* mund të sintetizohet duke iu referuar *yield-eve* më të fundit në ankandet primare, si edhe duke përdorur metodën e

- interpolimit, duke konsideruar *yield-et* e publikuara brenda një periudhe kohore jo më shumë se 3 muaj përpara ditës së vlerësimit. Për titujt referencë dhe për titujt e tjerë jo referencë që kanë maturim të ngjashëm me titujt referencë në kurbën e *yield-it*, të përdoret mesatarja e çmimeve bid të publikuara nga Banka e Shqipërisë;
- b. Çdo titull borxhi i zotëruar nga fondi i pensioni privat do të vlerësohet duke iu referuar *yield-it* të shlyerjes së titujve të borxhit në kurbën e *yield-it*, duke konsideruar numrin e viteve deri në shlyerjen e titullit që po vlerësohet. Nëse nuk ka titull borxhi të saktë të krahasueshëm të përfshirë në të dhënat e përdorura për llogaritjen e kurbës së *yield-it* mund të përdoret interpolimi;
  - c. Kurba e *yield-it* për obligacionet jo-qeveritare vlerësohet duke u bazuar në vlerësimin e kreditit (*credit rating*) të emetuesit dhe në vlerësimin nga shoqëria administruese të primit të rrezikut mbi obligacionet qeveritare me të njëjtin maturim që duhet të zbatohet për obligacionet me vlerësim të ndryshëm të rrezikut të kreditit (*credit rating*). Në përlllogaritjen e kurbës së *yield-it* primi i rrezikut i shtohet *yield-it* të obligacioneve qeveritare.
  - d. Për obligacionet e pa vlerësuar që nuk kanë vlerësim krediti (*credit rating*), shoqëria duhet të ketë një metodologji të brendshme të vlerësimit të rrezikut të kreditit për të llogaritur primin e rrezikut, i cili do t'i shtohet *yield-it* të obligacioneve qeveritare. Vlerësimi i kreditit për obligacionet e pa vlerësuar nuk mund të tejkalojë vlerësimet e shtetit përkatës si edhe duhet të marrë parasysh karakteristikat e instrumentit duke e krahasuar me instrumente të ngjashëm në tregje të rregulluara.
2. Vlera mund të përlllogaritet në mënyrë alternative duke përdorur flukset e ardhshme të parasë në lidhje me titullin e borxhit, të skontuara për të përlllogaritur vlerën aktuale duke përdorur një normë skontimi të verifikueshme në mënyrë të pavarur dhe objektivisht, e cila është e barabartë me *yield-in* e një titulli borxhi të ngjashëm.

## **Neni 19**

### **Metodat për çmimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, çmimi i vlerës së drejtë përcaktohet si zbatimi i vlerësimit më të mirë të shoqërisë administruese për shumën që një fond pensioni mund të marrë nga një shitje, ose që pret të paguajë për blerjen e një ose më shumë instrumenteve financiarë ose madje edhe të një portofoli të tërë instrumentesh financiare, në momentin e vlerësimit të aktiveve të fondit, me qëllim të garantimit të paanësisë midis anëtarëve që derdhin kontribute në fond, anëtarëve që kanë paraqitur kërkesën për shlyerjen dhe transferimin e kuotave dhe në vazhdim, që përfitohet nga:
  - a. Çmimet e kuotuar për aktivet ose detyrimet e ngjashme në tregjet aktive;
  - b. Çmimet e kuotuar për aktivet ose detyrimet identike ose të ngjashme në tregjet që nuk

- janë aktive;
- c. Inputet përveç çmimeve të kuotuarra për aktivet ose detyrimet, për shembull:
- i. Normat e interesit dhe kurbat e *yield-it* të vëzhgueshme në intervalet e zakonshme të kuotuarra;
  - ii. *Volatiliteti* i përlllogaritur (implied volatility);
  - iii. *Spread-i* i kreditit;
  - iv. *Input-et* që rrjedhin kryesisht nga ose janë konfirmuar nga të dhënat e tregut të vëzhgueshme sipas korrelacionit ose mënyrave të tjera.

## **Neni 20**

### **Procedurat nëse nuk ka të dhëna të krahasueshme**

Nëse nuk ka çmime ose çmime të krahasueshme të vëzhgueshme për aktivet ose pasivet, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, dhe në këtë mënyrë nuk ka çmime të mëparshme për këtë aktiv ose pasiv, pasi ai nuk është listuar ose tregtuar kurrë në platforma të tjera tregtimi, metodologjia që do të zbatohet duhet të bazohet në kritere shtesë.

## **Neni 21**

### **Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim (me kosto të amortizuar)**

1. Vlerësimi i investimeve të klasifikuara nga shoqëria administruese e fondeve të pensionit si aktive të mbajtura deri në maturim, do të kryhet me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit të realizuar në momentin e çdo investimi fillestar. Norma efektive e interesit do të shprehet të paktën me katër shifra pas presjes dhjetore, dhe shifra e fundit do të rrumbullakoset duke aplikuar metodën matematikore të rrumbullakosjes.
2. Në rastin e shitjes së një pjese të aktiveve të mbajtura deri në maturim, ose në rastin kur shoqëria administruese ndryshon synimin e saj ose humbet aftësinë për të mbajtur aktivet deri në maturim, aktivet totale të mbajtura deri në maturim do të rivlerësohen me vlerën e drejtë. Nga dita kur ndodh shitja e pjeseshme apo riklasifikimi, asnjë titull i mbetur nuk do të vlerësohet sipas metodës së zbatuar për aktivet financiare të mbajtura deri në maturim për dy vitet pasuese financiare. Përgjashtim do të bëjnë rastet e shitjes dhe riklasifikimit me karakteristikat e përshkruara nga SNRF.
3. Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim në përputhje me SNRF do t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit të tyre për çdo datë bilanci.
4. Aktivet financiare të klasifikuara si llogari të arkëtueshme do të vlerësohen me koston e amortizuar, duke zbatuar metodën e normës efektive të interesit.

## Neni 22

### **Vlerësimi i aksioneve dhe kuotave të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm**

Vlerësimi i aksioneve ose kuotave të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur, me ofertë publike përfshirë sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm, kryhet duke përdorur sa më poshtë:

- a. Çmimin më të fundit në blerje (*bid*) të aksionit ose kuotës të disponueshëm në kohën e vlerësimit nëse sipërmarrja në fjalë kuotohet me dy çmime (*bid/ask*) ose çmimin e vetëm nëse sipërmarrja në fjalë është me çmim të vetëm;
- b. Në rastin kur vlera neto e fondit të investimit nuk është publikuar, ose kur vlera neto e aktiveve për kuotë nuk është në dispozicion për ditën e vlerësimit vlera e drejtë e kuotës së blerë do të jetë çmimi i kuotës në ditën e mëparshme të ditës së vlerësimit, pra çmimi më i fundit që është botuar për atë fond investimi nga shoqëria përkatëse administruese.

## Neni 23

### **Vlerësimi i marrëveshjeve të riblerjes së titujve**

1. Transaksionet e shitjes së titujve dhe riblerjes së këtyre titujve në një ditë të përcaktuar në të ardhmen vlerësohen nga dita e transaksionit në një mënyrë që titujt, objekt i këtij transaksioni, të vazhdojnë të vlerësohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të llojit të titullit, ndërsa pasivët për fondet e mjeteve monetare të marra vlerësohen përmes llogaritjes së normës së interesit.
2. Transaksionet e blerjes së titujve dhe rishitjes së këtyre titujve në një ditë të përcaktuar në të ardhmen vlerësohen nga dita e transaksionit, si depozitat në maturim, përmes llogaritjes ditore të interesit.

## Neni 24

### **Depozitat bankare**

1. Depozitat bankare vlerësohen me vlerën nominale plus interesat e përlllogaritura.
2. Interesat e përlllogaritura duhet të kreditohen në llogarinë e të ardhurave.

## Neni 25

### Vlerësimi i instrumenteve derivativë - kontratat standarde të së ardhmes (futures)

1. Transaksionet e çdo kontrate standard të së ardhmes të lidhur me normat e interesit, këmbimet valutore, titujt ose mallrat bazë të tregtuara në një Bursë të njohur të tregtimit të *derivativeve*, vlerësohen çdo ditë me vlerën e tregut duke përdorur çmimin e kuotuar në blerje (*bid*) për transaksionin e fundit të bërë të ditur.
2. Transaksionet e kontratave standarde të së ardhmes (*futures*), për valutat e huaja vlerësohen çdo ditë në vlerën e drejtë.
3. Vlera e drejtë e një transaksioni *spot* për ditën e vlerësimit përcaktohet duke llogaritur kursin mesatar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në ditën kur janë vlerësuar aktivet e fondit.
4. Nëse nuk ka çmime të kuotuar zyrtarisht për kontratat standarde të së ardhmes në një bursë të njohur të *derivativëve* dhe nuk ka palë të treta të përcaktuara, vlera e drejtë e kontratës standard të së ardhmes bëhet sipas përcaktimeve të SNRF.

## Neni 26

### Vlerësimi i instrumenteve derivativë – *opsionet*

*Opsionet* e tregtuara në një Bursë të njohur të tregtimit të *derivativeve* vlerësohen me çmimin më të fundit të ofertës të tregtimit.

## SEKSIONI 4

### VERIFIKIMI DHE KONTROLLI I ÇMIMEVE

## Neni 27

### Verifikimi i çmimeve

1. Në rastet e instrumenteve financiare të listuara dhe të tregtuara në një treg kur ai treg është klasifikuar si aktiv, çmimet e përdorura duhet të rrjedhin ose nga informacioni i ofruar nga vetë tregu i njohur ose nga një ofrues ndërkombëtar i informacionit në lidhje me çmimet e instrumenteve financiarë i pranueshëm nga depozitari dhe Autoriteti.
2. Nëse çmimi i instrumenteve financiare në të cilat ekziston një treg joaktiv bazohet në metodologjinë e përcaktuar në këtë Rregullore, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat bie dakord me depozitarin që çmimi është i llogaritur saktë.

3. Nëse ekziston një transaksion midis fondit të pensionit privat dhe një personi fizik/juridik të lidhur, depozitari duhet të verifikojë se ky transaksion është kryer në përputhje me kërkesat e rregullores në lidhje me transaksionet me palët e lidhura.

## **Neni 28**

### **Kontrollet për vlerësimin dhe çmimet**

1. Shoqëria administruese duhet të vërtetojë se ka kontrolle efektive për llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës.
2. Kontrolli i referuar në pikën 1 të këtij neni garanton që:
  - a. Çmimet e aktiveve janë të sakta dhe të përditësuara;
  - b. Transaksionet e investimeve pasqyrohen në mënyrë të saktë dhe të shpejtë në vlerësimet;
  - c. Komponentët e vlerësimit rakordohen rregullisht me burimin e tyre;
  - d. Burimet e çmimeve që nuk merren nga burimi kryesor i çmimit regjistrohen dhe rishikohen rregullisht;
  - e. Dividendët kontabilizohen menjëherë kur titujt kuotohen ex dividend;
  - f. Të ardhurat nga titujt me interes fiks, nga dividendët, interesat dhe shpenzimet përlllogariten dhe kontabilizohen në secilën pikë vlerësimi, ose në kohën kur titulli është ex dividend ose ex interes ose pas marrjes;
  - g. Pozicioni tatimor, përfshirë tatimin në burim, rishikohet dhe përshtatet rregullisht, nëse është e nevojshme;
  - h. Janë vendosur toleranca të arsyeshme për devijimin nga elementet kryesore të një vlerësimi dhe lëvizjet që janë jashtë këtyre tolerancave investigohen;
  - i. Shoqëria administruese rregullisht shqyrton për saktësi vlerësimin e portofolit.

## **Neni 29**

### **Shpeshhtësia e kontrolleve**

1. Në ushtrimin e kontrollit të çmimeve, shoqëria administruese e fondeve të pensionit privat mund të bëjë zgjedhje të arsyeshme në përcaktimin e shpeshhtësisë së duhur të funksionimit të kontrolleve dhe mund të zgjedhë një interval më të gjatë, nëse është e përshtatshme, duke pasur parasysh nivelin e aktivitetit të fondit të pensionit privat ose rëndësinë e ndikimeve mbi çmimin.
2. Dokumentimi i ushtrimit të kontrollit të çmimeve ruhet në përputhje me periudhën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi.

3. Dokumentimi i gabimeve të vazhdueshme ose të përsëritura në lidhje me këto çështje dhe në veçanti çdo provë e gabimeve të cilat janë në interes të shoqërisë administruese ose personave juridik/fizik të lidhur tregon dështim të kontrolleve efektive.

## **SEKSIONI 5 INFORMIMI**

### **Neni 30 Informimi i Autoritetit**

1. Metodologjia e vlerësimit të aktiveve të fondit të pensionit e miratuar nga shoqëria administruese e fondeve dhe depozitari, depozitohet në Autoritet.
2. Çdo ndryshim në metodat e vlerësimit dakordësohet me depozitarin dhe depozitohet në Autoritet.

### **Neni 31**

#### **E drejta e Autoriteti të kërkojë përdorimin e një metodologjie të veçantë vlerësimi**

Autoriteti, kur e gjykon të arsyeshme, mund të udhëzojë shoqërinë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarin për të rënë dakord dhe për të zbatuar një metodologji të veçantë vlerësimi ose për të ndryshuar një metodologji ekzistuese për çdo kategori ose lloj aktivi, nëse sipas mendimit të tij:

- a. Metodologjia ekzistuese nuk ofron më një çmim të drejtë tregu;
- b. Nëse ndryshimet apo zhvillimet në tregjet e njohura e kërkojnë një ndryshim të tillë;
- c. Nëse ndryshimet në legjislacion e kërkojnë këtë;
- d. Nëse ka arsye të tjera se pse Autoriteti e konsideron këtë në interes të anëtarëve.

## **SEKSIONI 6**

### **LLOGARITJA E VLERËS NETO TË AKTIVEVE DHE ÇMIMIT TË KUOTËS**

### **Neni 32**

#### **Vlera neto e aktiveve dhe çmimi i kuotës së fondit të pensionit privat**

1. Vlera totale e aktiveve të fondit të pensionit privat, në ditën e vlerësimit, është shuma e vlerave të të gjitha llojeve të aktiveve të fondit të pensionit privat në këtë ditë.
2. Detyrimet e fondit të pensionit përfshijnë:

- a. Detyrimet lidhur me shlyerjen e kuotave, transferimin e aktiveve të anëtarit në një fond tjetër pensioni privat të administruar nga një shoqëri administruese tjetër dhe detyrimin lidhur me komisionin e transferimit;
  - b. Detyrimet lidhur me pagesat në formë kontributi të kryera në llogarinë e anëtarit;
  - c. Komisionin vjetor për administrimin e fondit të pensionit;
  - d. Detyrimet e lindura nga blerja e aktiveve deri në përfundim të procesit të shlyerjes, kur njohja e transaksionit bëhet në datën e tregtimit;
  - e. Të tjera detyrime të përcaktuara nga ligji dhe të parashikuara në Prospektin e fondit.
3. Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), rezulton nga diferenca ndërmjet vlerës totale të aktiveve të fondit të pensionit në ditën (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).
  4. Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit llogaritet dhe shprehet me dy shifra pas presjes dhjetore.
  5. Çmimi i kuotës në ditën e vlerësimit (t-1) llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të fondit të pensionit të ditës (t-1) me numrin total të kuotave të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).
  6. Çmimi me të cilin kryhet blerja dhe shlyerja e kuotave, llogaritet dhe shprehet si çmim i vetëm.
  7. Çmimi i kuotës i llogaritur në përputhje me këtë nen duhet të shprehet në një formë që është jo më pak se katër shifra pas presjes dhjetore.
  8. Çmimi i kuotës së fondit të pensionit privat mund të jetë i shprehur në lekë ose në një monedhë tjetër, siç përcaktohet në prospektin e fondit të pensionit privat.
  9. Shoqëria administruese garanton që çmimi i kuotës së fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur të llogaritet:
    - a. Duke iu referuar vlerës së përgjithshme neto të aktiveve të fondit të pensionit të llogaritur në përputhje me dispozitat e këtij Kreu;
    - b. Në përputhje me dispozitat e prospektit të fondit të pensionit.
  10. Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për anëtarët gjatë ditës (t-1) si dhe duke zbritur numrin e kuotave të shlyera nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, tërheqjeve të parakohshme dhe të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).

### **Neni 33**

#### **Pagesat në formë kontributi dhe shlyerja e kuotave**

1. Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit, si dhe aktivet e transferuara në fond, do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës.
2. Shlyerjet e kuotave në formën e pagesave të pensionit në mënyrë të menjëhershme, për tërheqje të parakohshme dhe për transferimin e aktiveve të anëtarit në një fond tjetër pensioni privat, do të vlerësohen me çmimin e kuotës së ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje.
3. Shlyerjet e kuotave në formën e pagesave të pensionit në mënyrë periodike, do të vlerësohen me çmimin e kuotës së ditës së shlyerjes së kuotave, që është një ditë përpara ditës së pagesës së përcaktuar në kontratën e veçantë, të lidhur për këtë qëllim ndërmjet shoqërisë administruese dhe anëtarit.
4. Transaksionet lidhur me blerjen, shlyerjen e kuotave si dhe transferimin e aktiveve të anëtarit në një fond tjetër pensioni privat, regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të blerjes, tërheqjes apo transferimit.

### **Neni 34**

#### **Afatet e përlllogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe rakordimi me Depozitarin**

1. Vlerësimi i aktiveve, vlera e neto e aktiveve dhe çmimi i kuotës së fondit të pensionit privat me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur llogariten për çdo ditë kalendarike në ditën e ardhshme të punës.
2. Depozitari, kontrollon dhe verifikon llogaritjen e vlerës neto të aktiveve të fondit dhe çmimin e kuotës në përputhje me politikat e kontabilitetit dhe metodologjinë e vlerësimit si dhe është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes.
3. Depozitari çdo ditë t, rakordon me shoqërinë administruese të dhënat lidhur me numrin e kuotave të fondit të pensionit privat, të dhënat e aktiveve dhe pasiveve, vlerën neto të aktiveve dhe çmimin e kuotës së fondit të pensionit privat të përlllogaritura nga ana e tij për ditën e vlerësimit t-1 me të dhënat e përlllogaritura nga shoqëria administruese e fondit të pensionit privat.
4. Shoqëria administruese dhe banka depozitare, duhet të përputhin me njëra-tjetrën në ditën

e vlerësimit vlerën neto të aktiveve, çmimin e kuotës dhe numrin e kuotave të fondit të pensionit për ditën e vlerësimit t-1.

5. Nëse depozitari gjatë kontrollit të llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit, identifikon pasaktësi dhe/ose parregullsi, njofton menjëherë me shkrim ose në mënyrë elektronike shoqërinë administruese që të dakordësohet mënyra e saktë dhe e shpejtë e zgjidhjes së parregullsisë.
6. Nëse shoqëria administruese gjatë llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit identifikon pasaktësi dhe/ose parregullsi, regjistron përkatësisht çdo rast për fondin e pensionit me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur dhe njofton me shkrim ose në mënyrë elektronike depozitarin së bashku me detajet e veprimeve të ndërmarra, ose që do të ndërmerren, për të shmangur përsëritjen sa më shpejt që të jetë e mundur.
7. Në rast se nuk arrihet ndonjë marrëveshje për zgjidhjen e problemit dhe llogaritja dhe kontrolli i vlerës neto të aktiveve të fondit nuk kryhen brenda ditës t, kur kryhet vlerësimi për ditën t-1, shoqëria administruese dhe depozitari duhet të raportojnë menjëherë dhe pa vonesa Autoritetin duke specifikuar arsyet për të cilat është e pamundur të përcaktohet vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit.
8. Shoqëria administruese së bashku me depozitarin, njoftojnë menjëherë Autoritetin në rast se çmimi i kuotës së fondit të pensionit me pjesëmarrje të hapur dhe të mbyllur konstatohet të jetë llogaritur gabimisht sepse:
  - a. Metodologjia korrekte për llogaritjen e vlerave neto të aktiveve nuk është zbatuar siç kërkohet nga dispozitat e Kreut II;
  - b. Është përdorur një çmim jo i saktë;
  - c. Ka një gabim aritmetik.
9. Shoqëria administruese së bashku me depozitarin, rillogarisin çmimin e kuotës në mënyrë që të përcaktojë çmimin e duhur dhe informojnë për këtë Autoritetin.
10. Në rastin e llogaritjes së pasaktë të çmimit të kuotës së fondit të pensionit me mbi 1 %, krahasuar me vlerën e llogaritur nëpërmjet zbatimit të metodologjisë së përcaktuar në Ligj dhe në këtë rregullore, Autoriteti mund t'i kërkojë shoqërisë administruese përgjegjëse për këtë llogaritje të pasaktë që të ndërmarrë hapat e mëposhtëm:
  - a. Në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i ulët se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave për çdo diferencë në shumën e marrë nga kuotat e shlyera dhe të kompensojë fondin për çdo diferencë në shumën e arkëtuar për kuotat e shitura;
  - b. Në rastin kur çmimi i llogaritur për kuotën është më i lartë se vlera korrekte, e përcaktuar sipas kësaj metodologjie, të kompensojë çdo mbajtës të kuotave që i blen

kuotat nëpërmjet shpërndarjes së kuotave shtesë dhe të kompensojë fondin për çdo vlerë përtej çmimit të paguar për kuotat e shlyera.

11. Pas korigjimit dhe ndryshimit të përlllogaritjeve të vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe çmimit të kuotës, shoqëria administruese dhe depozitari do të rakordojnë përsëri të dhënat dhe do të raportojnë në Autoritet.
12. Depozitari dhe shoqëria administruese kryejnë rakordim mujor të të dhënave të fondit të pensionit privat dhe balancave të llogarive të anëtarëve të fondit, brenda afateve të përcaktuara në rregulloret e brendshme të depozitarit.

### **Neni 35**

#### **Publikimi i informacionit**

Shoqëria administruese publikon në faqen e saj zyrtare të internetit çdo ditë për ditën e vlerësimit (t-1), çmimin e kuotës së fondeve dhe vlerën neto të aktiveve pas rakordimit dhe konfirmimit me depozitarin e fondit.

### **Neni 36**

#### **Raportimi në Autoritet**

1. Mos rakordimi i të dhënave sipas pikës 3 të nenit 34 duhet të raportohet në Autoritet nga depozitari në mënyrë elektronike jo më vonë se dita e njëjtë e punës.
2. Raportet mbi vlerësimin e aktiveve të fondit të pensionit dhe llogaritja e vlerës neto të aktiveve për kuotë do të përgatiten nga depozitari për fondet e pensionit privat, për të cilat ai ofron shërbime depozitari dhe do të dërgohen në Autoritet, me anë të postës elektronike si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë link-ut vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit për këtë qëllim çdo ditë, brenda orarit zyrtar të ditës kur bëhet vlerësimi, për ditën e vlerësimit (t-1).
3. Forma dhe përmbajtja e informacionit sipas pikës 2 të këtij neni, janë përcaktuar në Tabelën nr. 1, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
4. Depozitari raporton me shkresë në Autoritet, me anë të postës elektronike si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë link-ut vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit brenda 3 ditë pune të muajit pasardhës, të dhënat ditore, të detajuara në pikën 2 të këtij neni, për të gjithë muajin paraardhës.

5. Depozitari raporton me shkresë në Autoritet, me anë të postës elektronike si dhe në formë elektronike nëpërmjet sistemit pranë link-ut vënë në dispozicion në faqen zyrtare të Autoritetit, mbi portofolin e investimeve të aktiveve të fondit të pensionit, për vlerën nominale dhe kontabël të këtyre aktiveve si dhe për datën e maturimit të instrumenteve financiarë që përbëjnë portofolin e investimeve.
6. Forma dhe përmbajtja e informacionit sipas pikës 5, janë përcaktuar në Tabelën nr. 2, Shtojca 1, që është pjesë integrale e kësaj rregulloreje.
7. Depozitari raporton në Autoritet brenda datës 15 të muajit pasardhës, pas përfundimit të çdo tremujori të vitit, të dhënat mbi portofolin e investimeve.
8. Shoqëria administruese dhe Depozitari, me kërkesë të Autoritetit, raportojnë për procedurat e vlerësimit të aktiveve dhe detyrimeve të fondit të pensionit privat.
9. Depozitari raporton në Autoritet në baza tremujore duke përmbledhur numrin e rasteve të çmimeve të pasakta të secilit fond pensioni privat për të cilët ofrojnë shërbime depozitare gjatë periudhës në fjalë.
10. Depozitari nënshkruan dokumentin që përmban përcaktimin e vlerës së aktiveve dhe mban një kopje në dosjen e vet, e cila i vihet në dispozicion Autoritetit në inspektim, sipas kërkesës.

### **Neni 37** **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, rregullorja nr. 139, datë 26.09.2012 "Për përlllogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondit të pensionit vullnetar dhe afatet e publikimit të informacionit" shfuqizohet.

### **Neni 38** **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë

## SHTOJCA 1

Tabela nr. 1

<b>Informacioni mujor</b>			
<b>Data</b>	<b>Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit (NAV)</b>	<b>Numri i kuotave të fondit të pensionit</b>	<b>Çmimi i kuotës i fondit të pensionit (NAV/Kuotë)</b>

Tabela nr. 2

<b>Portofoli i investimeve të fondit të pensionit</b>					
<b>Instrumenti</b>	<b>ISIN</b>	<b>Vlera nominale</b>	<b>Vlera kontabël</b>	<b>Monedha</b>	<b>Data e maturimit</b>

## **SHTOJCA 2**

### **Lista e bursave aktive dhe indekseve**

Për qëllimin e kësaj rregulloreje, titujt e tregtuar në bursat, platformat tregtare shumëpalëshe dhe indekset e mëposhtme, do të konsiderohen si letra me vlerë të tregtuara në tregun aktiv.

#### **1. Tregjet aktive**

Bursa Australiane

BME - Bursa Spanjolle

Bursa e Frankfurtit

Bursa e Hong Kongut

Bursa e Italisë

Bursa e Koresë

Bursa e Londrës

Bursa e Luksemburgut

NASDAQ

Bursa e Nju Jorkut

Euronext

Bursa e Zelandës së Re

Bursat OMX Nordic

Bursa SIX Zviceran

Bursa e Shangait

Bursa Shenzhen

Bursa e Tokios

Bursa e Torontos

## **2. Indekset**

AEX-Index

Amex

Indeksi CAC 40

CAC Tjera 20

Deutsche Boerse AG German Stock Index DAX- Indeksi i Aksioneve në Gjermani DAX

Dow Jones & Company

EURO STOXX 50 Çmimi EUR

Indeksi

Indeksi i FTSE 100

Indeksi i FTSE MIB

Indeksi FTSE MID 250

Indeksi Hong Kong i Hang Seng

Indeksi IBEX 35

JPX400 Indeksi Lux - Bursa e Luksemburgut

MICEX

MSCI

Nikkei 225

Indeksi OBX

Indeksi OMX Stockholm 30

RTSI

Indekset Russell

SBF 250

Standard & Poor's

S & P / ASX 200

Indeksi i Tregut të Zvicrës

Topix